

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **NPL KASTRIOTI -26-3327-1-3-6**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me drita dhe material percjelles per mirembajtjen e ndriqimit publik**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>AG INSTAL SH.P.K.</b>
NUI	<b>811863598</b>
Adresa	<b>Rruga Balshaj, nr 9</b>
Vendi	<b>Millosevë</b>
Kodi postar	<b>15000</b>
Numri Telefonit	<b>044158423</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Granit Vrshevc</b>
Adresa elektronike	<b>granitvershevc98@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>08.07.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

#### **Furnizim me drita dhe material percjelles per mirembajtjen e ndriqimit publik**

**I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejme do të i referohemi LPP-së) dhe atë konkretisht:**

- ? **Nenit 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- ? **Nenit 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**
- ? **Nenit 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**
- ? **Nenit 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit**
- ? **Nenit 60, Kriteret për dhënie të kontratës,**
- ? **Neni 61, Tenderët Jo-normalisht të Ulët**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

**Procerverbali i hapjes se tenderave eshte bere me date: 23.06.2026.**

**Ne kete proceverbal ne jemi shpallur si OR te pa-pergjeshem, per here te dyte mbrenda 2 muajve, ne procedura 99% te ngjashme.**

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga

*AK gjate kontestit paraparak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*

**AK ka refuzuar te gjitha pikat ne kerkesen tone per rishqyrtim, ndersa nuk mund t'a bashkangjis ketu pergjigjen pasi nuk eshte opsioni per shtim.**

**Dokumentin e kerkuar e gjeni ne attach,**

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Pretendojmë e se Autoriteti Kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje te dispozitave të;

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejme do të i referohemi LPP-së ) dhe atë konkretisht:

Ë Nenit 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Ë Nenit 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Ë Nenit 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Ë Nenit 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit

Ë Nenit 60, Kriteret për dhënie të kontratës,

Ë Neni 61, Tenderët Jo-normalisht të Ulët

II. Rregullores për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, Nr.01/2024

Ë Neni 4, Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

Ë Nenit 17, Dosja e Tenderit

Ë Nenit 25, Kriteret e përzgjedhjes

Ë Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Pretendimi nr 1.

Shkelja e nenit 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues me vendimin e vet që të shpërblej me kontratë tenderin e Operatorit ekonomik; ; Konstant sh.p.k, Rruga, Skënderbeu, P/n ,Podujeve ne vlere prej 6,730.07 euro, ka bere shkelje te dispozitave te nenit 6, paragrafin 1. dhe paragrafi 2, te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 6. paragrafi 1 dhe 2 te këtij ligji,

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Bazuar ne Vendimin e AK-se për rezultatin e tenderit i cili ka propozuar për shpërblim te kontratës, tenderin e OE ne vlere totale me te shtrenjtë ne shume 6,730.07 euro ne krahasim me tenderin e parashtruesit te kësaj ankesë i cili ka qen ofertë prej 6,550.00 euro e ka dëmtuar buxhetin e AK-se dhe taksapaguesve te Kosovës dhe me këtë rast ka bere shkelje te dispozitave te nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 te LPP-se.

Pretendimi nr.2

Shkelja e Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues me vendimin e vet që të shpërblej me kontratë tenderin e OE; Konstant sh.p.k, Rruga, Skënderbeu, P/n ,Podujeve ne vlere prej 6,730.07euro, ndërkaq tenderin e parashtruesit te ankesës e ka eliminuar pa baze ligjore dhe si rrjedhoje e kësaj ka kryer trajtim jo te barabartë dhe diskriminim ndërmjet OE dhe shkelje te dispozitave te nenit 7, paragrafin 1,2,3, dhe paragrafi 6, te LPP-së në Republikën e Kosovës .

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 7. paragrafi 1,2,3 dhe 6 te këtij ligji,

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.
3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.
6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtëse të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse

Bazuar në Vendimin e AK-se për rezultatin e tenderit i cili ka propozuar për shpërblim të kontratës, tenderin e OE; ; Konstant sh.p.k, Rruga, Skënderbeu, P/n ,Podujeve në vlerë prej 6,730.07 euro i cili për nga çmimi është më i lartë në krahasim me çmimin e ofertuar të parashtruesit të ankesës, ka kryer diskriminim dhe trajtim JO TE BARABARTE të operatoreve ekonomik gjatë VLERSIMIT TE DOKUMENTACIONITTE TENDERIT të operatoreve ekonomik. Këtë diskriminim e ka kryer edhe me rastin e vlerësimit të përgjigjes në sqarim të tenderit lidhur me çmimin e ofruar në ofertën financiare, ku të njëjtën përgjigje e ka bërë një operator tjetër dhe e kanë trajtuar si përgjigje bindëse lidhur me arsyetimin e çmimit , ndërkaq përgjigjen e parashtruesit të ankesës e cila ka përmbajtur të njëjtin arsyetim, e kanë konsideruar si përgjigje jo bindëse.

### **Pretendimi nr.3**

**Shkelja e Nenit 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

**Pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 56 ,**

**paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.**

**Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 te këtij ligji,**

**Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:**

**1.1. së pari, vlerësimi të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;**

**1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.**

**Bazuar ne Njoftimin për tenderues te eliminuar si dhe bazuar ne nenin 56 te LPP-se, Autoriteti Kontraktues, është i obliguar qe tenderin ta vlerësoj në pajtim me kriteret për kualifikim dhe përzgjedhje te OE te përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe ne dosje te tenderit.**

**Autoriteti kontraktues nuk e ka vlerësuar tenderin ne harmoni me kërkesat për kualifikim dhe përzgjedhje, te përcaktuara ne Njoftimin për kontrate dhe ne Dosjen e tenderit, për me tepër parashtruesin e ankesës e ka eliminuar me arsyetimin se nuk e ka nënshkruar dhe vulosur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, kërkesë e cila nuk është kërkuar ne nenin III te Dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratës.**

**Ne baze te arsyetimit ne letrën standarde te eliminimit nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit shohim qarte se AK ka eliminuar parashtruesin e ankses për një kusht formalo administrativ te cilin nuk e ka kërkuar ne dosjen e tenderit dhe ne Njoftimin për kontrate dhe si rrjedhoje e kësaj pretendojmë se ka bere shkelje te nenit 56 te LPP-se**

Pretendimi nr.4

Shkelja e Nenit 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni nenin 59 te LPP-se ne momentin kur ka marre vendim për shpërblim te kontratës për OE i cili ka dorëzuar tender te me çmimin me larte ne krahasim me parashtruesin e ankesës si dhe vendimin për eliminimin e tenderit te parashtruesit te ankesës, ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 te dispozitave te LPP-se.

Ne vijim po citoj dispozitat e nenit nenin 59, paragrafi 1 dhe paragrafi 4 i cili përcakton;

**1. Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacioni dytësor lidhur me këtë çështje.**

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkojen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve

Bazuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të publikuar nga ZPP i prokurimit i cili në arsyetimin e saj për eliminim shkruan;

[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

J. Ju mungon deklarata mbi Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME  
Sqarim: Sipas DT

NENI II QELLIMI I KONTRATES paragrafi II.4 Specifikimet e detyrueshme teknike - punët

0 fumizimet C8] shërbimet D duhet të jene plotësisht në pajtueshmëri me specifikimet teknike të! Parashtruara në dosje të! tenderit, Aneksi 1

2. Komisioni i vlerësimit ka konstatuar se keni çmime ab normalisht të ulëta në disa pozicione dhe pas kërkesës nga AK për sqarimin e çmimeve ju nuk keni dërguar mjaftueshëm sqarime bindëse se si mund të na furnizoni.

Duke marrë parasysh të gjeturat e lartcekura oferta e juaj konsiderohet si oferte e papërgjegjshme. Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/Atë Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Bazuar ne nenin 59.4 te LPP-se AK është i obliguar qe tenderin ta vlerësoj vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Kushtet për pjesëmarrje ne tender-kuotim kane qen te caktuara ne nenin III te Njoftimit për kontratë.

Vazhdon

Ne vijim citoj nenin III.2 te Njoftimit për kontrate;

### III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kerkesa nr.1 Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092. {Deklarata e shkruar nën Betim

Dëshmia 1 Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit AK ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është së paku pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të AK-se për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do të vazhdohet sipas Ligjit të Prokurimit Publik për mos dorëzim me kohë të dokumenteve dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në ranglistë. Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërisë janë me se vijon a)-Vërtetim te lëshuar nga gjykata apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2,

dhe 4.4, ( jo me e vjetër se 6 muaj para datës se B05 Njoftimi per Kontrate PKQ 4 6 B05 B05 B05 Njoftimi per Kontrate PKQ 4 6 Njoftimi per Kontrate PKQ 4 6 Njoftimi per Kontrate PKQ 4 6 dorëzimit të tenderit Origjinal ose e B05 Njoftimi per Kontrate PKQ 4 6 noterizuar b). Një vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve dhe kontributeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës se dorëzimit të tenderit - kopja c) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme-origjinal ose e noterizuar

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesa nr.1 Certifikata e regjistrimit të biznesit (ARBK dhe informatat e biznesit)

Dëshmia nr.1 Kopja e certifikatës së biznesit me informatat e biznesit

Kërkesa nr.2 Certifikata e TVSH-së Dëshmia nr.1 Kopja e certifikatës së TVSH-së

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Dëshmia e kërkuar dokumentare:

:

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës Furnizim me drita dhe material përcjellës për mirëmbajtjen e ndriçimit publik , gjate 3 viteve të fundit (nga data e publikimi të Njoftimit për Kontratë), në një vlerë prej jo me pak se 14,500.00

Dëshmia 1 Kur furnizimi, shërbimi, puna është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata raporti i përkohshëm i pranimi) të rëndësishme të lëshuar ose të bashke nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë (Psh Fatura);

si dhe ne NENIN III - KËRKESAT të cilat duhet të përmbushen nga OPERATORET

EKONOMIK te dosjes se tenderit te cilat kane qen si ne vijim;

### III.1 KËRKESAT E PËRSHTATSHMËRISË

Dëshmi të dokumentuara për kërkesat e përshtatshmërisë:

a. një deklaratë me shkrim nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.

dhe

III.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale Përshtatshmëria profesionale Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesa nr.1 Certifikata e regjistrimit të biznesit (ARBK dhe informatat e biznesit)

Dëshmia nr.1 Kopja e certifikatës së biznesit me informatat e biznesit

Kërkesa nr.2 Certifikata e TVSH-së Dëshmia nr.1 Kopja e certifikatës së TVSH-së

III.3 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare Kapaciteti ekonomik dhe financiar Dëshmia e kërkuar dokumentare:

III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kapaciteti teknik dhe professional Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës Furnizim me drita dhe material përcjellës për mirëmbajtjen e ndriçimit publik , gjate 3 viteve të fundit (nga data e publikimi të Njoftimit për Kontratë), në një vlerë prej jo me pak se 14,500.00 Dëshmia 1 Kur furnizimi, shërbimi, puna është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të - VAZHDON

këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashke nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë (Psh Fatura);

Bazuar ne dispozitat e LPP-se si dhe bazuar ne kushtet për kualifikim dhe pjesëmarrje ne tender pretendojmë se AK këtë vendim për eliminim e ka marre ne kundërshtim te plote me gjendjen faktike dhe dëshmitë dokumentare te cilat i OE i ka dorëzuar ne afatin e caktuar dhe ne harmoni te plote me kërkesat e AK-se te përcaktuara ne Njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit.

Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara pretendojmë se AK gjate zhvillimit te procedurës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te tenderit ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se.

## Pretendimi nr.5

### Shkelja e Nenit 60, Kriteret për dhënie kontratës

Pretendojmë se AK përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate një OE i cili ne është rekomanduar për shpërblyerje të kontratës dhe ka ofruar çmimin me të lartë, ne krahasim me çmimin e ofruar nga parashtruesi i ankesës, i cili ka ofruar çmimin me të ulte dhe është eliminuar pa baze ligjore, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 60 të LPP-se, duke mos respektuar Kriterin për dhënie të kontratës i cili ka qenë i përcaktuar në Njoftimin për kontrate dhe në dosje të tenderit; Çmimin më të ultë, i tenderit të përgjegjshëm.

Citoj dispozitën e nenit 60 të LPP-se;

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Duke u bazuar në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit shohim se AK për këtë aktivitet të prokurimit ka kërkuar nga OE që në tenderin e tyre të ofertojnë "çmimin me të ulte të tenderit të përgjegjshëm", shohim qartë se OE i shpërblyer me kontrate e ka ofruar çmimin më të lartë në krahasim me parashtruesin e ankesës i cili ka ofruar çmimin me të ultë, pretendojmë se AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-se duke shkelur çmimin me të ulte.

## Pretendimi nr 6,

### Shkelja e nenit 61, Tenderët jo normalisht të ulte

Pretendojmë se AK përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate një OE i cili ne është rekomanduar për shpërblyerje të kontratës dhe ka ofruar çmimin me të lartë, ne krahasim me çmimin e ofruar nga parashtruesi i ankesës i cili ka ofruar çmimin me të ulte dhe është eliminuar pa baze ligjore, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 61 të LPP-se, duke mos respektuar procedurën e kualifikimit të nocionit Çmim jo normalisht i ulte.

Ne vijim po e citoj dispozitën e nenit 61 të LPP-se;

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim: (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafit 2. të këtij neni.

2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të marrë parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

- 2.1. ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
  - 2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
  - 2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
  - 2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.
3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.
4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin”

Autoriteti kontraktues gjate trajtimit inter partes te tenderuesit ka aplikuar gabimisht dispozitën e nenit 61.3 te LPP-se duke e trajtuar përgjigjen ne kërkesën për sqarim te çmimit jo normalisht te ulte si jo bindëse edhe përkundër faktit qe parashtruesi i ankesës ka ofruar sqarim te nevojshëm si dhe ka deklaruar se është i gatshëm qe te implementoj kontratën sepse çmimi i ofruar është i favorshëm edhe për kontraktuesin dhe AK. AK është dashur te veproj konfrome neni6 61.3 dhe trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë sepse dallimi ndërmjet fituesit te kontratës ne çmim është shume i vogël pra vetëm 179.22 euro apo vetëm 2.67 %.

Konceptin e tenderit jo normalisht te ultë ne mënyrë me detale e ka rregulluar Rregullores Nr.02/2024 për Plotësimin dhe Ndryshim të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik e cila përcakton kushtet dhe procedurën e trajtimit te çmimi jo normalisht te ulte.

II. Pretendimi i shkeljeve të Rregullores Nr.02/2024 për Plotësimin dhe Ndryshim të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Shkelja e Neni 4, Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit  
Shkelja e Neni 17, Dosja e Tenderit  
Shkelja e Neni 25, Kriteret e përzgjedhjes  
Shkelja e neni 41, Tenderët Jo-normalisht të Ulët

Pretendimi numër 7.

Shkelja e Neni 4, Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

Pretendojmë se AK përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të eliminuar AG INSTAL shpk, ka bere shkelje të dispozitës së nenit 4 të Rregullores për Prokurimin Publik, duke eliminuar konkurrencën e lire ne treg, duke mos vepruar ne mënyrë efikase dhe efektive te parasë publike, duke

favorizuar një operator ekonomik dhe duke diskriminuar të tjerat duke mos vepruar në mënyrë transparente.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 7 të Rregullores.

4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

- a. të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasinë, karakteristikat teknike dhe garancive;
- b. për aq sa është e mundur në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe
- c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

4.2 Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë përgjegjësi në lidhje me ndonjë tenderues ose kandidat, ose pjesëmarrës në një procedurë të prokurimit publik, përveç nëse një vendim për kompensim të ankuesit është nxjerrë nga Organi Kompetent (OSHP ose Gjykata kompetente).

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

- a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrë më efektive dhe me efektive.
- b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paratë për Autoritetin Kontraktues.
- c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
- d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.
- e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.
- f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.
- g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.

Bazuar në Vendimin (arsyetimin) për eliminimit nga aktiviteti i mëtejshëm i prokurimit i cili sipas dëshmive dokumentare ka plotësuar të gjitha kushtet për kualifikim dhe pjesëmarrje në tender si dhe bazuar në dispozitat e nenit 4 të Rregullores për Prokurimin Publik, shohim qartë se AK nuk ka vepruar në pajtim me parimet për administrimin e procedurave të prokurimit dhe si rrjedhojë e kësaj ka bërë shkelje të nenit 4 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Shkelje e Nenit 17, Dosja e Tenderit

Pretendojmë se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 17 të Rregullores për Prokurimin Publik sepse ai, është përgjegjës për përgatitjen e dosjes së tenderit, caktimin e kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterit për dhënies të kontratës .

Ne vijim citojmë nenin 17.15 , 17.23 dhe 17.25 të Rregullores ;

Neni 17.15 përcakton qartë si ne vijim;

17.15 Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes së tenderit. Ai është plotësisht përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të tenderit, kriterëve të përzgjedhjes, si dhe kriterëve të dhënies, ndërsa specifikimet teknike do të përgatiten nga struktura të specializuara në çështjen që do të prokurohet, brenda AK. Në rastet e kontratave komplekse ose të veçanta, AK mund të caktojë ekspert të jashtëm ose Kontraktorë, për të ndihmuar njësinë në hartimin e Dosjes së Tenderit. AK do të zbatoj dispozitat e LPP-së kur angazhohen ekspert të jashtëm ose Kontraktorë.

Paragrafi 17.23 Në përputhje me nenin 31, paragrafi 1 i LPP-se, Autoritetet kontraktuese mund të vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet, me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit 7 të LPP-se dhe që janë paraqitur në dosjen e tenderit. Kërkesat e tilla në lidhje me ekzekutimin e një kontrate kanë qëllim të sigurojnë një nivel të caktuar të kushteve të punës ose të mbrojtjes së mjedisit

Paragrafi 17.26 Një Autoritet Kontraktues mund të specifikojë në dokumentacionin e kontratës institucionin apo institucionet nga të cilat një kandidat apo tenderues mund të marrë informatat e duhura për obligimet që kanë të bëjnë me tatimet, mbrojtjen e mjedisit, dispozitat e mbrojtjes së punëtorëve dhe për kushtet të cilat janë në fuqi.

Bazuar në dosjen e tenderit si dhe në njoftimin për kontrate, të Autoritetit kontraktues, shohim se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i cili është përgjegjës që të zbatoj kushtet për kualifikim dhe përzgjedhje të OE, si dhe kriterin për dhënie të kontratës nuk ka vepruar në harmoni me nenin 28 të LPP-se që ndërlidhet me nenin 17 të Rregullores për prokurimin Publik.

Pretendimi nr 9

Shkelje e Nenit 41, Tenderët Jo-Normalisht të ultë

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të trajtuar ofertën e AG INSTAL “ si ofertë e pa përgjegjshme për shkak të ofrimit të çmimit jo normalisht të ulte ka vepruar në kundërshtim me nenin 41 të tenderët Jo-Normalisht të Ultë të Rregullores për Prokurimin Publik.

Për të trajtuar një ofertë me çmim jo normalisht të ulte në bazë të kësaj Rregulloreje duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 41.

Ne vijim po i citojmë kushtet e përcaktuara në nenin 41.3 të Rregullores për Prokurimin

Publik, ne cilat raste dhe cilat kushte duhet te plotësohen për te aplikuar dispozitat e kësaj Rregulloreje;

41.1 Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës.

41.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët.

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

41.6 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët.

- a. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

41.7 Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.

41.8 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

41.9 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore,

Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

41.10 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:

a. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose

b. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulët", brenda dy dite nga data e vendimit.

41.11 Tenderuesi në fjalë do të informohet për rezultatin final të vlerësimit

Duke pasur parasysh faktet se;

A. çmimi i ofruar në vlerë prej 6,550.85 euro nuk është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm,

Bazuar në Njoftimin mbi Vendimin e AK-se (B58) tender të përgjegjshëm AK ka shpallur kater OE dhe atë;

1. Constant SH.P.K i cili ka ofruar çmimin 6,730.07 euro,
2. "Item EL" SH.P.K., i cili ka ofruar çmimin në vlerë prej 7,581.00 euro
3. N.P.T. " EL DRENI ", i cili ka ofruar çmimin në vlerë - VAZHDON

rej 9,358.00 euro

4. Eor Group SH.P.K., i cili ka ofertuar me çmimin në vlerë 9,495.00 euro,

Pra çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm është 8,291.01 euro që done të thotë se parashtruesi i ankesës nuk është 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm.

B. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët

pra çmimi i ofruar nga parashtruesi i ankesës në vlerë prej 6,550.07 nuk është 10% më i ulët se çmimi i tenderit të dytë por është 2.67% që done të thotë se nuk është plotësuar as kushti i dytë për të aplikuar dhe trajtuar ofertën me çmim jo normalisht të ulët.

Duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura pretendojmë se AK gjatë procedurës së vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka bërë shkelje të nenit 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Duke pasur parasysh këto fakte kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i Prokurimit që pas administrimit të fakteve dhe provave të marrë;

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

### **Dëmet materiale**

**Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.**

**Deri më tani dëme materiale në vlerë prej 500 euro për përgatitjen e Kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës.**

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*